

## Shtëpia pasive

Sot shumica e njerëzve dëshirojnë ambient të këndshëm dhe me kualitet për banim. Kur zgjidhet mënyra e ndërtimit është shumë i madh kujdesi i cili ka lidhje me shpenzimet e ndërtesës për banim (shpenzimet e nxemjës, shpenzimet e energjisë elektrike, shpenzimet e ftohjes, shpenzimet e ujit...). Shpenzimet e mëdha të energjisë i detyrojnë investitorët që gjatë zgjedhjes së metodës ndërtimore ose renovimit të objekteve të zvogëlohet varja energjetike, për këtë çdo here e më shumë për ndërtim ose renovim arrin normat të cilat diktojnë ndërtimin e objekteve pasive ose me energji të ulët.

Përpjekjet serioze për ndërtimin e objektit me shpenzime efiçiente daton që nga viti 1973., por zhvillimi i tyre është ndaluar për shkak të shpenzimeve të mëdha në krahasim me kursimin e energjisë sa zgjatë qëndrimi i objektit. Investimet ishin më të volitshme për objekte pasive, të cilët janë treguar si kursyes me të mirë energjie. U bë baza për përcaktimin e kriterëve të cilët janë me rëndësi për objekte pasive. "Shtëpia pasive" e Institutit nga Darmstadta për shkak të eksperiencës dhe diturisë në lëmin e ndërtimit pasiv u bë një trup referimi rëndësishme i cili ndan certifikata objekteve që plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- kërkesa për energjinë për ngrohje të jetë më e vogël se  $15 \text{ kWh/m}^2\text{a}$  (lidhur me zonat e banuera) - më e ultë se  $10 \text{ W/m}^2$ ,
- shpenzimet primare të energjisë mos të kalon  $120 \text{ kWh/m}^2\text{a}$ ,
- mos lëshimi i arritur të jetë më së paku  $N50 = 0,6/\text{h}$ .



Tek projektimet e objekteve pasive është me rëndësi të shfrytëzohen vetit natyrore të çdo parcele dhe të kemi parasysh ndarjen e ambientit për objekte të cilat shfrytëzojnë vetitë e dhënë të parcelës. Ndërtimi i objektit pasiv kërkon kujdes për çdo detal tek të gjithë kontraktorët, sepse është e domosdoshme të kemi kujdes gjatë lidhjes së materialeve të ndryshme, të sigurohet mos lëshimi dhe izolim i mirë objekti pa ura ngrohëse. Objektet punuese me vlera të ulëta që na përcaktohen ndërtohet sipas standardeve RAL, sepse është mënyra e vetme për të siguruar mos lëshime nëpër hapje. Ajrosja e ambientit është e balancuar nëpërmes ajrosjes së domosdoshme. Kur ndryshon ajri, ajri i freskët pjesërisht nxehet »tretet« ajri i cili merr një pjesë nxehtësie gjatë daljes nga objekti.

Për sigurimin e duhur të izolimit ngrohës në objekte pasive trashësia e izolimit duhet të përshtatet kualitetit të izolimit. Lëvizshmëria e përgjithshme termike (vlera U) për çatitë, muret dhe dyshemetë duhet të jetë brenda  $0,10-0,15 \text{ W/m}^2\text{K}$ .

Sot në treg ka shumë lloje të izolime termike. Ato i ndajmë në materiale izoluese klasike dhe alternative (BIO) materiale izoluese. Izolimi klasike në përgjithësi kanë një përçueshmëri më të ulët termike, çka do thotë se mund të vendosim izolimin termike me trashësi më të vogël. Tek instalimet izoluese alternative është e mundur me trashësi më të vogël të arrimë faza më të gjata të cilat më ngadalë e përçojnë nxehtësinë nëpër konstruktion. Çdo izolim termik i ka përpirësitit mit dhe dobësitë e veta. Se cilën do ta zgjedhë, për çdo investitor është vendim i vështirë.

Me këto të dhëna mund të vijmë në përfundim që për ndërtimin e objekteve pasive janë të përshtatshme të gjitha izolimet ngrohëset të cilat gjenden në treg. Gjatë vendosjes së izolimit termik duhet pasur kujdes që izolimi termik ti përshtatet konstruktionit. Izolimet termike janë të prodhuara për këtë konstruktion dhe nuk rekomandohet të përdoret për montimin e konstrukcioneve tjera sepse izolimi nuk është i shfrytëzuar plotësisht.

URSA në programin për shitje ka prodhime minerale prej leshit të xhamit (URSA GLASSWOOL dhe URSA TERRA) si dhe prodhime oliestri (URSA XPS) të përshtatshme për vendosje në konstruktion të pullazit, mure të jashtme, mure ndarëse, konstrukcione mes-kateve, konstrukcione në dyshemesh, mbështjellës muresh në podrume dhe nën pllaka për themele të objekteve po ashtu. Leshi i qelqit me vetitë e përsosura në lëmin e izolimit termik ( $\lambda$  është nga 0,044 do 0,032 W/mK) dhe izolimi i zërit (zëri kumbues dhe zëri lirisht përhapet nëpër ambient) i URSA XPS (poliester) me tension të lartë rezistues, izolimin ngrohës, rezistenca e ujit tek ngrirja dhe shkrirja i mundëson që izolimeve me vendosje të përshtatshme të ndërtoni objekte të cilat i plotësojnë të gjitha kushtet e objekteve pasive.

